



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Zyra e personelit

Nr. Prot: 462
Datë: 24.2.2020

Në bazë të Nenit 12 pika 4 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149, si dhe Nenit 18 të Rregullores nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil:

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" shpall

KONKURS

Për këto vende të lira pune me afat të caktuar në Universitetin Veror Ndërkombëtar të Prishtinës 2020 (UVNP):

Zyrtar i përkohshëm administrativ (3 punonjës) - në kohëzgjatje prej: **23.03.2020** deri më **22.07.2020**.

Kandidatët të cilët konkurrojnë për këto vende pune, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbyesit Civilë të Republikës së Kosovës, duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

Të kenë përgatitja shkollore superiore, të kenë aftësi të mira komunikimi, shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve të Word, Excel, Power Point, Access, e nevojshme njohja e gjuhës angleze.

Detyrat – përgjegjësitë:

- Regjistron studentët vendor në bazën e të dhënave;
- Ndihmon në vendosjen e studentëve dhe profesorëve në konvikte;
- Ndihmon në organizimin e ekskursioneve;
- Ndihmon në editimin dhe përgatitjen e materialeve të ndryshme për UVP;
- Bënë përgatitjen e forumeve dhe punëtorive;
- Asiston në përgatitjen e hapjes dhe mbylljes së Universitet Veror të Prishtinës;
- Kryen edhe punë të tjera që caktohen nga udhëheqësi.

Konkursi mbetet i hapur **7 ditë** nga dita e shpalljes në ueb-in e UP-së, gjegjësisht deri më **01.03.2020**.

Në zbatim të nenit 11 pika 2 të Ligjit për Shërbyesit Civilë të Republikës së Kosovës, ftohen që të konkurrojnë edhe kandidatët nga komunitetet minoritare në Kosovë.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në **Rektoratin** e Universitetit të Prishtinës Rr. "George Bush", p.n. 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës, **zyra nr. 1**.

Aplikacionet për konkurrim mund të shkarkohen në: www.uni-pr.edu ose mund të merren me rastin e aplikimit për këto vende pune.

Në procedurën e pranimit të kandidatëve, do të bëhet intervistimi i kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet sipas konkursit.

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë edhe numrin e telefonit kontaktues.

